



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2667 Prot.

Tiranë, më 16.10 2023

VENDIM QARKULLUES

Nr. 113 dt. 16.10 2023

**“PËR
EMËRTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË FORMIMIT TË VAZHDUAR NË
FUSHËN PSIKO-PEDAGOGJIKE, SIPAS URDHËRIT TË MAS DHE MIRATIMIN E
PROPOZIMIT TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT PËR KËTË
PROGRAM”**

Në zbatim të nenit 3 pika 2 gërma b, nenit 38 pika 1 gërma dh, nenit 81 të ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M-së nr 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, Udhëzimit të MAS nr.3, datë 15.02.2023 “Për përcaktimin e diplomave universitare të njëvlershme, të ngjashme ose të përafërta me fushën/ lëndët e mësimdhënies në Arsimin Parauniversitar dhe kriteret për hapjen e e programeve të studimeve të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike” i ndryshuar, Urdhërit nr.374 datë 14.07.2023 të MAS “Për hapjen e programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike, në UST”, nenit 20 të Statutit të UST-së, nenit 7 të Rregullores së Universitetit të Sporteve të Tiranës, si dhe në shkresat e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes nr. 2491 Prot., datë 05.10.2023 “Përcjellje për miratim e “Programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike” në FSHL” dhe nr.2586/1 prot. datë 12.10.2023 “Përcjellje e propozimit për tarifën e shkollimit për “Programin e studimit të formimit të vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike”, në Vendimin e Rektoratit nr.107, datë 16.10.2023, Senati Akademik i Universitetit të Sporteve të Tiranës

V E N D O S I :

1. Emërtimin e programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike në edukimin fizik, sport dhe shëndet, në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes, të UST-së, **“Programi i studimit të formimit të vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike”**, sipas

Urdhërit nr.374 datë 14.07.2023 të MAS “Për hapjen e programit të studimit të formimit të vazhduar në fushën psiko-pedagogjike, në UST”.

2. Miratimin e propozimit të tarifës së shkollimit për këtë program, sipas tabelës bashkëlidhur.
3. Ky vendim i përcillet për miratim, zbatim dhe publikim Bordit të Administrimit, Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Shërbimeve Akademiko Shkencore.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. AGRON KASA



Fakulteti Shkencave të lëvizjes

Tarifa e aplikimit	2.500 lekë
Tarifa e regjistrimit	2.000 lekë

Emërtimi i Programit	Tarifa (ne lekë) për 35 kredite në lekë
Programi i studimit të formimit të vazhduar në fushën Psiko-Pedagogjike	35.000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2667 Prot.

Tiranë, më 16, 10, 2023

VENDIM QARKULLUES

Nr. 113 dt. 16, 10, 2023

“PËR
EMËRTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË FORMIMIT TË VAZHDUAR NË
FUSHËN PSIKO-PEDAGOGJIKE, SIPAS URDHËRIT TË MAS DHE MIRATIMIN E
PROPOZIMIT TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT PËR KËTË
PROGRAM”

Prof.Dr. ADRIATIK META

Prof.Asoc. ARBEN KAÇURRI

Prof.Asoc. BASHKIM DELIA

Prof.Dr. DHIMITRAQ SKËNDERI

Prof.Dr. DHURATA BOZO

Dr. ELTON SPAHIU

Prof.Dr. FATOS GJATA

Prof.Asoc. FERDINAND MARA

Prof.Asoc. JUEL JARANI

Prof.Asoc. ROBERT ÇITOZI